



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

V E N D I M

Nr. 02 , Datë 01 / 03 /2021

“Për ngritjen e Komisioneve të Zgjedhjeve në njësitë përbërëse të UT-së dhe fillimin e procesit të vetëkandidimit për anëtarë të tyre”








Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës”, Kreu II, neni 7, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në UT;

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Zgjedhjeve në:
 - Fakultetin e Ekonomisë
 - Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë
 - Fakultetin e Shkencave të Natyrës
 - Fakultetin e Drejtësisë
 - Fakultetin e Shkencave Sociale
 - Fakultetin e Gjuhëve të Huaja
 - Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar
 - Filialin e UT-së, Sarandë
2. Shpalljen e hapjes së procesit të vetëkandidimit për anëtarë të Komisionit të Zgjedhjeve në Fakultete; të Institutit të Fizikës Bërthamore dhe të Filialit të Sarandës, në Universitetin e Tiranës.
3. Regjistrimi i kandidatëve për këto komisione, fillon në datën 08.03.2021 dhe përfundon në datën 12.03.2021, nga ora 08.00 – 15.00. Regjistrimi i kandidatëve kryhet pranë Sekretarisë Teknike të KIZ, pranë Rektoratit të UT-së, ose elektronikisht, në adresën kizut2021@unitir.edu.al, sipas formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.

4. Vendimi dërgohet për zbatim në të gjitha fakultetet, Institutin e Fizikës Bërthamore dhe Filialin e Sarandës, të UT-së.
5. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e fakulteteve; të Institutit të Fizikës Bërthamore dhe të Filialit të Sarandës, të UT-së dhe në faqet e tyre zyrtare.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- | | | |
|---------------------|-----------|--|
| 1. Edvin Lame | (Kryetar) |  |
| 2. Xhensila Kadi | (Anëtare) |  |
| 3. Alnida Koroshi | -//- |  |
| 4. Shaniko Allajbeu | -//- |  |
| 5. Arjan Tushaj | -//- |  |
| 6. Eljon Doçe | -//- |  |
| 7. Dhurata Saraçi | -//- |  |